




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 20.02.2026

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesja e Kuvendit me datë: 20.02.2026 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e II-të të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **27.02.2026**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 30.01.2026.
2. Pyetje legjislativiteti drejtuar ekzekutivit.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026
4. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunes së Kamenicës.
5. Të ndryshme.




Arbnore BEQIRAJ FERA

Kryesuesja e Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-rë, e rregullt e Kuvendit të Komunës së Kamenicës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës më datë: 30.01.2026 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, zyra e informimit, zyrtar komunal, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues nga Handikoss. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Kuvendit të Komunës, znj. Arbnore Beqiraj Fera, e cila për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 29.12.2025.
2. Pyetje legjislativ të drejtuar ekzekutivit.
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2025.
4. Shqyrtimi i Raportit të Kuvendit Komunal të Kamenicës për vitin 2025.
5. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor (TM4) 2025.
6. Propozim vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033
7. Shqyrtimi i Informatës nga Raporti i Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025
8. Shqyrtimi i Informatës së Këshillit Komunal për Siguri dhe Bashkësi (KKSB) për vitin 2025.
9. Shqyrtimi Raportit të Performancës Komunale për vitin 2024.
10. Propozim Vendim për themelimin e grupit punës për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2026.

11. Kërkesë nga MAPL për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. Sh.01 Nr. 36248.

12. Kërkesë nga MAPL për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. Sh.01 Nr. 21283.

13. Të ndryshme.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Përshëndetje të nderuar të pranishëm, të nderuar delegat, i nderuar Kryetar mirë se po takohemi në mbledhjen e I-rë për vitin 2026, para se me filluar konstatojmë se kemi kourum të mjaftueshëm për të filluar mbledhjen.

A keni propozime për rend dite ? Nëse Jo atëherë hedhim në votim për miratim rendin e ditës
Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për 19

Kundër 0

Abstenim 0

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga Mbledhja e mbajtur me datë 29.12.2025

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal - jemi në pikën e parë në rend dite është Shqyrtimi dhe Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 29.12.2025, A keni vërejtje rreth procesverbalit? Atëherë nëse jo e hedhim në votim

Kush është për miratimin e procesverbalit?

Për 15

Kundër 0

Abstenim 0

2. Pyetje legjislativë drejtuar ekzekutivit

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi në pikën e dytë Pyetje legjislativë drejtuar ekzekutivit. A keni pyetje ? Fjala për Shpresa Sermaxhaj

Shpresa Sermaxhaj – Përshëndetje për të gjithë, faleminderit Kryesuese. Unë dua ta ndaj një shqetësim nga prindërit dhe mësuesit të gjithë të rinjtë e Komunës sonë nën moshën 18 vjeçare po kanë qasje dhe mundësi të blejnë cigare duke përfshirë edhe ato cigare elektrike, gjatë bisedës me nxënës nga shkollat e mesme i pyeta se ku po bëjnë blerjen e këtyre produkteve, ata më thanë që me shumë lehtësi në secilin dyqan të Komunës sonë, andaj propozoj që në Kuvendin Komunal të miratim Vendim për ndalimin e shitjes së këtyre produkteve për personat nën moshën 18 vjeçare, për të mitur duke lejuar shitjen e këtyre vetëm me ID.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Labinot Haxhiu
Labinot Haxhiu, Faleminderit, pyetje për Kryetarin, se çka po ndodh me Trotuarin në Rubovs po punohet pjesë-pjesë dhe besoj se keni njohuri ?

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Granit Berisha

Granit Berisha, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, unë edhe nga KPF kamë ngritur një shqetësim, kam bërë kërkesë që pyetja ime ti drejtohet edhe Drejtorit të Arsimit, i cili për momentin është U.D. Qerdhja në fshatin Koretin ,gjithë e dimë që kjo qerdhe është përruar para mbajtjes së zgjedhjeve lokale, banorët e fshatit Koretin kanë shpresuar që ka mu funksionalizuar. Kemi nevojë me ditë pse nuk është funksionalizuar kjo qerdhe, sa është nr. i stafit që u rekrutua, kur i kanë marrë kontratat, nga cila datë janë aktive dhe ku janë për momentin në shërbim punëtorët që janë rekrutuar atje, e nuk janë duke punuar në qerdhen e fshatit Koretin ?

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, nga KPF kemi kërkesë edhe për Drejtorin e DAP për të dhënë Informata por njëherë, fjala për Kryetarin e Komunës për të dhënë përgjigje.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit Kryesuese, mirë se po takohemi të gjithë këshilltarët komunal, uroj që ky vit të jetë i mbarë për të gjithë ne dhe faleminderit për kontributin e vazhdueshëm. Unë do përgjigjem për ato informacione që më takojnë dhe i kam këtu para vetës. Sa i përket pyetjes për blerjen e cigareve qofshin ato klasike apo elektronike dhe shitjen e tyre, kjo rregullohet me legjislacion prej nivelit qendror të Republikës së Kosovës, të gjithë shitësit duhet ta respektojnë mënyrën se si duhet shitur këto cigare qofshin klasike apo elektronike, inspektorati komunal është në zbatim të planit të tij të miratuar në bashkë vendim me drejtorët që kemi pasur në fund të vitit 2025, gjitha njësit ose sektorët e komunës kanë një planë të punës që duhet ta realizojnë gjatë këtij viti 2026, trupa inspektuese është duke marrë një sërë masash për shkeljet që po bëhen në teren, shumë shpejtë do të publikohen edhe në ueb-faqen e Komunës së Kamenicës, neve si Kuvend Komunal nuk na takon të nxjerrim një vendim të tillë pasi që kjo tashmë është e rregulluar Ligjërish.

Tretuari në Rubovs është në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal, kemi pasur sfida sa i përket çështjeve pronësore shumë qytetar kanë hezituuar ti lirojnë ato..

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, të nderuar për arsyeje të ndërprerjes elektrike patëm një ndërprerje, vazhdojmë me mbajtjen e mbledhjes fjala për Kryetarin

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës faleminderit edhe njëherë isha duke thënë se Tretuari në Rubovs është në bashkëfinancim në vlerë prej 194 mijë euro me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal, kemi pasur sfida dhe vështërsi sa i përket çështjeve pronësore me shumë qytetar, që janë të rëndomta. Drejtoria për Investime Kapitale ka negociu me disa qytetar disa kanë leju e disa jo, aty ku na mundësohet puna ne do të punojmë do vazhdoj puna e këtij projekti. Në raport me qerdhen e Kretinit e vërtet që qerdhja është inauguruar në vitin e kaluar, ka qenë menaxhim dhe investim i MASHT-it, ata kanë vendos për inaugurimin dhe pas përfundimit për procedurat e rekrutimit nga Komuna e Kamenicës për stafin adekuat aty ka dal të jetë një problem me furnizim energjetik, pajisjet e kuzhinës shpenzojnë më shumë rrymë se sa një nevojë që e ka trafo e regjionit, Komuna e Kamenicës ka zhvillu procedurën për furnizim me trafo të re, procedura e njëjtë ka përfundua në organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, pas kthimit të përgjigjes të Organit Shqyrtues Publik, ne jemi në vlerësim të ofertës dhe besojë që oferta e përgjegjshme do ta realizoj projektin në kohë, stafi po aftësohet në qerdhen e qytetit, dhe shumë shpejtë edhe Qerdhja e Koretinit do jetë në funksion. Më lejoni që të adresoj do çështje që janë ngritur në KPF, për

ngrohjen në Shkollën mikse “Sejdi Kryeziu” në Roganë, është thënë që ka pasur probleme me ngrohje për një periudhë të gjatë, këtu është një e vërtetë që probleme ka pasur por jo për një periudhë të gjatë kohore. Kaldaja e vjetër ka dal jashtë funksionit dhe Drejtoria ka inicuar procedurë të shpejtë për furnizim të një Kaldaje të re, ku vlera e kësaj kaldaje është 12.994 euro dhe problemi është sanuar dhe si pasojë e kësaj janë dy ditë të humbura të mësimi. Vlerësimi i dëmeve nga vërshimeve ju e dini që vërshimet kanë prekur edhe fundin e vitit të kaluar dhe fillimin e këtij viti, ndërsa Drejtoria për Shërbime Publike dhe Ambient janë pranuar 60 kërkesa për vlerësim të dëmeve për vërshimet e muajit dhjetor, dëmet zakonisht janë shkaktuar në ekonomi familjare kryesisht, biznese por edhe në infrastrukturë publike. Pas raportit përfundimtar të vlerësimit, ky raport do të dërgohet në komisionin qendror atje dhe do ta shohim mundësin e bashkëpunimit me ta. Shqetësimet e ngritura për tretuarin në Kopernicë, gjatësia e tretuarit nga pena deri te qafa është diku 840 metra, rrjeti i ndriçimit publik do të shtrihet përgjatë tij dhe një pjesë të tretuarit të vjettër me gjatësi diku 1215 metra, vlera e kontratës është 90.698 euro, aktualisht janë punuar dy shtresa të zhavorrit si dhe është punuar kanali anësor për ujrat atmosferik vlera e pagesës deri më tani është 40.302 euro, projekti është 1 vjeçar. Nga KPF kemi shqetësime për tenderin që është për dekorimin e qytetit zyra e prokurimit dhe komisioni përkatës kanë zgjedhë një fitues që është një operator ekonomik me vlerë prej 21.786 euro operatori tjetër ka të drejtë ankese në organin shqyrtues të prokurimit publik, ndërsa eksperti i angazhuar nga OSHP ka kthyer përgjigje në Janar të këtij viti, dhe nuk ka pasur interesa që Komuna e Kamenicës të zhvillojë procedurë të mëtejshme, ose ta anulimit të kësaj procedure ose të ruajmë këtë kontratë për këtë vit që dekorimi i qytetit të bëhet në fund të këtij viti. Shqetësimi tjetër i ngritur në KPF Pastrimi i lumenjve Komuna e Kamenicës ka një kontratë për pastrimin e lumenjve dhe proçkavë është kontratë komizë 3 vjeçare, vlera është pak sa e vogël 150 mijë euro, punë të realizume janë këto: Pastrimi i proçkavë të një segmenti në fshatin Berivojcë në vlerë 900 Euro, pastrimi i një segmenti të lumit Roganë-Hodonovc në vlerë 23.475 euro, pastrimi i një segmenti në kopernicë 17.395 euro, pastrimi i një segmenti të lumit të shtrembur vlera 76.500 euro, pastrimi i prroit të Shkollës në Karaqevë të Epërme në vlerë me 1500 euro, rregullimi i gardhit të ura në lagjen malësia vlera 1440 euro, si dhe pastrimi i prroit në Hodonoc të rruga Basha, si dhe pastrimi i prroit në Koretin të rr. Haqif Canaj vlera 5100 euro, pastrimi i përroit në Kamenicë të Shkollës e Mesme vlera 4850 euro, total punë të kryera janë 130 mijë euro, ndërsa shuma e mbledhur në kontratë 19.840 euro, pra kontrata është shpenzuar për kohë të shkurtë dhe duhet të shohim mundësitë që kjo kontratë duhet të shpallet përsëri të jemi si masë paraprijëse për vërshimet e ardhshme. Ndërsa sa i përket kërkesës së znj. Magbule Kastrati për Rerformacës e Qendrës për Shërbime me Qytetar dhe Gjendjes Civile do na njoftojmë më shumë Drejtoret e Kësaj Drejtorie.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, ftojme Drejtoreshen Arlindë Sejdiu për të dhënë informata.

Arlindë Sejdiu – Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Përsërisht për të gjithë, faleminderit për pyetjen Raporti në Drejtorinë e Administratës – Janar-Dhjetor 2025

Drejtorja e Administratës, ka punuar me përkushtim të plotë gjatë gjithë vitit 2025, Gjendjes Civile ka përfunduar 29,471 dokumente, prej të cilave janë 324 kurora në total. Ndërsa Qendra për Shërbime me Qytetarë ka pranuar 36,426 kërkesa, prej të cilave 25,947 janë të

dedikuara për Drejtorinë e Administratës , të gjitha janë shqyrtuar dhe trajtuar me sukses. Sa i përket të hyrat për Janar--Dhjetor 2025 kanë qenë: 31 448.50.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Drejtoreshë, a keni pyetje? Fjala për Granit Berishën

Granit Berisha, faleminderit Kryesuese, në përgjigjien që më dha Kryetari të pyetjes sime, për mua është e pjesshme , sepse kërkesa ishte me ditë sa është numëri i të rekrutuarëve në qerdhe dhe a nuk ka pasur mundësi që Komuna mi paraprijë problemit me trafo dhe funksionalizimit të kësaj qerdhe, gjithashtu Kryetari tha që këta të punësuar janë duke u aftësuar në qerdhen e qytetit më duket jo serioze sepse këta punëtorë është dashtë të jeni të aftësuar para se të rekrutohen, idea është të dimë sa është numëri dhe nga cila datë ose muaj janë akive kontratat me punu në Koretinë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal fjala për Magbule Kastratin

Magbule Kastrati, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Ne si Komitet për Politikë dhe Financa kemi kërkuar që i pranishëm në mbledhje të jetë edhe ish-Drejtori i Arsimit Afrim Dërvishi, por ai gjatë 4 viteve paraprake nuk ka mare pjesë në mbledhje më shumë se 90% të rasteve. Kryetar ju kisha lutur që nëse emëroni dikë tjetër apo edhe këtë që kur të bëhen kërkesa të vijnë në mbledhje të rregullt.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal fjala për Shpresa Sermaxhaj

Shpresa Sermaxhaj, Faleminderit Kryesuese, kam një replikë për Kryetarin ne e dimë që është e rregulluar Ligjërisht por sa është e zbatueshme pasi që unë ju tregova që në bisedë me nxënësit dhe kur i kam pyetur kanë treguar që i blejnë lehtësisht kudo në Komunën tonë, si Komunë duhet me ndërmarrë diçka në bashkëpunim edhe me inspektorat që mos të lejohen shitja e këtyre produkteve të miturve, sepse ne i dimë pasojat që rrjedhin si për fëmijë dhe familjet e tyre.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal fjala për Labinot Skovrqani

Labinot Skovrqani, Faleminderit Kryesuese, për vërsimet që kanë ndodhurë janë bërë 60 Kërkesa a pranohen kërkesa edhe tutje a ka afate ngase njerëzit nuk kanë pasur njohuri dhe kanë mungesë informimi, për dëmet që kanë ndodhur a formohen Komisione nga Komuna apo vetëm Zyrrat përgjegjëse që janë ?

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal fjala për Kryetarin

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamënicës, Përshëndetje Lab, Formohet Komision nga Komuna e Kamënicës që del në teren dhe bënë vlerësimin e demit, mund të dorëzohen ende kërkesa për Dëmet por vlerësimi real është pak më i vështirë se ka kaluar një kohë, pas Raportit Përfundimtar, Raporti dorëzohet në Komisionin Qendror për Vlerësim të Dëmit që është bërë në nivel vendi, pjesa e madhe e vendit ka pasurë vërsime në këtë

periudhë.. Në raport me shitjen e cigareve ajo duhet të rregullohet sipas ligjit që specifikon se në cilën moshë lejohej shitja e Cigareve dhe Alkoolit, mandej e rregullon edhe formën se si duhet të paraqiten në dyqane dhe markete, ajo është e rregulluar Ligjërisht, se çka ne mund të bëjmë është të Inspektojmë se sa po respektohet Ligji kundrejt fëmijëve dhe shitëseve, këtë mund ta bëjmë dhe jemi duke e bërë çdo ditë e do ta bëjmë edhe në vazhdimësi. Në raport me Qerdhen në Koretin janë të punësuar 17 punëtor, 8 Edukatore, 2 Motra Edukatore, 1 Zyrtar Administrativë që është në fazë të Rekrutimit, 2 kuzhinier, 1 punëtor teknik dhe 1 Mirëmbajtës, stafi po ndan përvojën me qerdhen e qytetit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar, a kemi pyetje të tjera për diskutim? Atëherë shkojmë te pika e 3-të

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika e tretë ka të bëjë me Raportin e Punës së Kryetarit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, dhe fjalën për prezantimin e këtij Raporti ia kalojmë Kryetarit të Komunës, z. Kadri Rahimaj.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, Të dashur qytetarë të Kamenicës,

Sot po dal para jush për të përmbushur jo vetëm një obligim ligjor, por një detyrim moral, të jap llogari për besimin që na keni dhënë. Raporti i punës për periudhën korrik-dhjetor 2025 është dëshmia e një transformimi që po ndodh në çdo lagje e në çdo fshat të komunës sonë. Ky gjashtëmujor nuk ka qenë thjesht periudhë e menaxhimit të përditshëm, por një fazë ku projektet e mëdha kanë marrë formë dhe ku transparenca është bërë standard i padiskutueshëm.

Financat dhe Qeverisja: Duart e Pastra si Standard

Nuk mund të flasim për rrugë e shkolla pa folur për mënyrën se si menaxhohet paraja publike. Për herë të parë në historinë e institucionit tonë, ne kemi një Opinion të Pastër nga Auditori i Jashtëm. Kjo nuk është thjesht një letër është certifikata e ndershmërisë sonë. Me një buxhet të planifikuar prej mbi 15.6 milionë eurosh për vitin 2026, ne kemi dëshmuar se dimë të planifikojmë dhe të kërkojmë fonde. Kemi rritur arkëtimin e të hyrave vetanake dhe kemi treguar disiplinë financiare, duke e bërë Kamenicën model për komunat e tjera. Në Raport me Infrastrukturën

Në këtë gjashtëmujor, fokusi ynë ka qenë lidhja e qytetarit me infrastrukturën rrugore. Investimet në fshatra: Kemi investuar masivisht në Hogosht, Koretin, Koperrnice, Muqiverc Karaçevë të Poshtme dhe të Epërme, si dhe në Krilevë e Strezovc. Për ne nuk ka qytetarë të dorës së dytë, rruga e fshatit më të largët është po aq e rëndësishme sa rruga qendrore e qytetit. Projekti i rrugëve lokale në Krilevë (mbi 750 mijë euro) dhe ai në Feriqevë (mbi 860 mijë euro) janë investime që do të ndryshojnë ekonominë lokale për dekadat e ardhshme.

Kemi punuar në pastrimin e shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra përmes Ndërmarrjes publike Dardana. Është pastruar lumi i shtrëmbur në qytet, lumenj dhe

proçak të tjerë si në Berivojcë, Rogane e Hodonovc, Koperrnicë, Karaqevë, Rubovc dhe Koretin.

Arsimi dhe Rinia: Investimi te Gjenerata e Re

Arsimi nuk është kosto, është investim.

Kemi bërë përrurimin e çerdhes në Koretin (741,000 euro) është dhurata jonë më e mirë për prindërit e rinj dhe pas zgjidhjeve të problemeve me KEDS dhe furnizimin me trafon e re, pritët të hy në funksion së shpejti, për shkak që komuna ka rekrutuar të gjithë stafin.

Kam nderin të njoftoj se kemi ndarë bursa për 154 studentë. Ajo që më gëzon më shumë është fakti se 101 prej tyre janë vajza. Kjo tregon se po ndërtojmë një shoqëri të barabartë ku merita dhe arsimimi janë parësore.

Janë instaluar kamerat e sigurisë, shkollat tona sot janë mjedise më të kontrolluara dhe më cilësore.

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Tani kemi dy autoambulanca të reja kemi ulur kohën e reagimit në raste emergjente.

Kuzhina Popullore: Një projekt që buron nga zemra – investimi prej gjysmë milioni eurosh siguron që askush në Kamenicë të mos mbetet pabukë. Ky është solidariteti në veprim. Ndërsa fëmijëve në të gjitha shkollat pa ua bëjmë gati ushqimin e shëndetshëm nga kjo kuzhinë.

Nga Kultura, Sporti dhe Diaspora

Kamenica ka frymuar këtë verë. Përmes "**Kamenica Summer Fest**", ne jo vetëm që mirëpritëm mërgatën tonë, por u dhamë mundësi artistëve, rinise dhe sportistëve tanë të shkëlqejnë.

Anëtarësimi në "**Mayors for Peace**" e ka vendosur emrin e qytetit tonë krah metropoleve botërore që promovojnë paqen dhe bashkëjetesën.

Nuk po them se nuk kemi sfida. Kemi ende punë për të bërë në menaxhimin e mbeturinave, në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe në krijimin e më shumë vendeve të punës për të rinjtë. Por, me buxhetin e rritur të vitit 2026 ne jemi gati të ballafaqohemi me këto sfida.

Të nderuar delegatë,

Ky raport nuk është vetëm i imi, as vetëm i drejtorëve të mi. Ky është raporti i bashkëpunimit mes nesh.

Ne kemi dëshmuar se premtimet i kthejmë në kontrata, dhe kontratat në punë të kryera.

Vazhdojmë bashkë, me duar të pastra dhe me punë të mbara!

Ju faleminderit shumë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar a kemi diskutime rreth kësaj pike ? Nëse jo kalojmë te pika e 4-të,

4. Shqyrtimi i Raportit të Kuvendit Komunal të Kamenicës për vitin 2025.

Shqyrtimi i Raportit të Kuvendit Komunal për vitin 2025, ky raport përfaqëson aktivitetet e kuvendit komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2025, dhe fjalën për këtë Raport ja japim, znj. Violeta Krasniqi nga Shërbimi i Kuvendit.

Violeta Krasniqi, Zyrtare për punë të Kuvendit Komunal, I nderuari Kryetar, Kryesuese e Kuvendit.

Të nderuar anëtar dhe anëtare, dhe ju të pranishëm të tjerë

Në përputhje me kompetencat ligjore, dokumentacionin zyrtar dhe funksionin institucional të Kuvendit Komunal, sot para jush prezantojmë Raportin e Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025

Raporti paraqet një pasqyrë të aktiviteteve, vendimeve dhe angazhimeve institucionale të realizuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025.

Ky raport është hartuar në përputhje me kompetencat ligjore të Kuvendit Komunal dhe reflekton punën në Legjislaturën e VII-të, e cila ka pasur në përbërje 27 asamblastë dhe është udhëhequr nga Kryesuesi Liridon Kastrati.

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, mbi aktivitetet e Kuvendit Komunal i cili Kontribon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënien e Kuvendit.

Kuvendi Komunal ka trupat ndihmës pra dy Komitete të Përhershëm atë për Politikë dhe Financa që ka 7 anëtar si dhe Komitetin për Komunitete i përbërë prej 9 anëtarëve.

Kuvendi Komunal për gjatë vitit 2025 ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta, ka mbajtur 2 mbledhje të Solemne dhe 1 mbledhje të Jashtëzakonshme me Legjislaturën e VII-të, si dhe 1 Mbledhje Inauguruese, 1 mbledhje të Rregullt me Legjislaturën e VIII-të.

Gjatë vitit 2025 janë miratuar 128 akte.

Nga këto në rishqyrtim për harmonizim nga MAPL janë kthyer 10 akte, të cilat janë harmonizuar brenda afatit ligjor, sipas rekomandimeve që ka dhënë MAPL.

Për arsyeje të shpalljes të zgjedhjeve komunale, MAPL ka pezulluar 11 vendime për të cilat procedura ligjore është sipas legjislacionit në fuqi, pra ne kemi pranuar Konfirmimin zyrtar që janë akte të ligjshme mirëpo ekzekutimi i tyre është ndërprerë deri në formimin e institucioneve të reja.

Si përfundim në këtë raport janë të përfshira të gjitha pikat që janë trajtuar në mbledhjet e kuvendit komunal në vitin 2025, raport të cilin ju e keni pranuar me kohë bashkë me materialin e kuvendit për këtë mbledhje.

Nëse keni diçka për të pyetur apo për sqarime jam në dispozicionin tuaj, nëse jo Faleminderit për vëmendjen!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Violeta. Jemi tek pika 5 ka të bëjë me Raportin Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor, për të cilin Raport do të paraqitet nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, fjalën e ka z. Selami Zylfiu, U.D i kësaj Drejtorie.

5. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor (TM4) 2025.

Selami Zylfiu – U.D i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Faleminderit përshëndetje për të gjithë, fillimisht urime për mandatin e ri të gjithë delegatëve që kanë fituar ju uroj shëndet e suksese në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve. Ne po paraqesim Raportin Buxhetor Financiar të Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor 2025, respektivisht TM4 të vitit fiskal. Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës, mbulon 3 mujorin e 4-të të vitit fiskal dhe paraqet një informatë për të gjitha arkëtimet respektivisht të hyrat, shpenzimet dhe investimet. Në Komunën e Kamenicës gjithsej të hyra vetanake Tetor-Dhjetor 2025 janë 154 mijë e 248 euro. Nuk po lëshohemi në të gjitha detajet se ka shumë indikator por i keni të bashkëngjitur Tabelat, tabela e parë paraqet të hyrat vetanake të inkasuar në baza vjetore dhe krahasuar me vitet 2023-2025 për periudhën e njëjtë të vitit fiskal respektivisht TM4. Shuma totale e të hyrave për këtë periudhë ka qenë 144 mijë 248 euro, Tabela e dytë paraqet të hyrat vetanake të inkasuar me baza mujore sipas drejtorive sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve respektivisht llojit të të hyrave. Gjatë muajit Tetor kanë qenë 51547.38 euro të hyrave, në muajin Nëntor kanë qenë 37673, në muajin Dhjetor kanë qenë 6527.77 që në total bëjnë 154.248.85. Sipas kategorive ekonomike i kemi të shpalosura edhe sipas Kodeve të caktuara, Kategoria e Pagave në TM4 ka pasur 2.107.928.59 euro, ndërsa në vitin 2025 në tre mujorin e njëjtë janë 2.458.199.85 ose 116.62 %. Në kategorinë Mallra dhe Shërbime shpenzimet në tre mujorin e njëjtë për vitin kaluar janë 863.567.42 euro, për vitin 2025 janë 686.732.58 respektivisht 79.52 %. Shpenzimet komunale kanë pasur një ndryshim të vogël, kanë qenë më të vogla 67.003.73 , ndërsa subvencionet 225932.75 në vitin e kaluar ndërsa në këtë vit 180.905.45 euro, Investimet Kapitale kanë qenë 119.3447.31 ndërsa në këtë periudhë janë 529.494.68 euro, 44.4%. Sa për informatë dhe konkluzion i keni sipas klasifikimit ekonomik, si përmbledhje të gjitha kategoritë ekonomike kanë një shpenzim të mirë të buxhetit që në total është 97.40 % për periudhën Janar-Dhjetor 2025. Kategoria e Pagave është shpenzuar 99.87 %, Mallra dhe Shërbime kanë qenë 95.63 Shpenzime Komunale 99.96, Subvencione dhe transfere 99.85 %, Investimet Kapitale 90.04 %, që paraqet një performacë jashtëzakonisht të mirë të buxhetit, nuk ka pasur asnjëherë një performacë të till me buxhet. Faleminderit për durimin tuaj.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje rreth kësaj pike ?
Atëherë kalojmë në pikën e gjashtë.

6. Propozim vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika e gjashtë ka të bëjë me Propozim vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033

Planin Zhvillimor Komunal

PZHK ka kaluar në kuvend, është miratuar, është përcjell në afat ligjor në procedurën për shqyrtim të ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe është konfirmuar si akt i ligjshëm.

Megjithatë, bazuar në rekomandimin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Plani është kthyer në rivotim në Kuvendin Komunal dhe të votohet nga një përbërje që nuk ekziston konflikt interesi, andaj duke u thirrur në këtë kontest Kuvendi duhet të rivotoj, duke u vetpërfshirë nga diskutimi dhe votimi të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal për të cilët ekzistojnë rrethana që përbëjnë konflikt interesi qoftë i drejtë për drejt, qoftë interes familjar apo përmes personave të angazhuar, në cilën do rrethanë jeni të obliguar të vet përfshihen nga ky diskutim dhe rivotim.

Kjo thirrje e imja, për deklaram do të evidentohet në procesverbal nga Shërbimi i Kuvendit, përgjegjësia ligjore për mos deklaram mbetet individuale e secilit anëtar, ne përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shtoj këtu që me votimin e këtij vendimi , **Shfuqizohet Vendimi me nr. Sh. 01 Nr. 21270 i dt. 06.08.2025, për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për vitin 2025-2033.**

Ju lutem që anëtarët e kuvendit që në një formë kanë Konflikt Interesi për këtë pikë të vetpërfshihen nga ky diskutim dhe votim.

Konflikt Interesi kanë: Magbule Kastrati, Albulena Gagica dhe Labinot Skovrqani ju kisha lutur që të na lironi për këtë votim dhe diskutim.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Kryetarin e Komunës

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit për të gjithë, e para unë nuk pajtohem plotësisht me atë që e ka shënuar Agjencioni , sepse një logjikë e tillë mund të na nxjerr shumë sfida në të ardhmen, sidoqoftë një gjë duhet ta kemi të qartë që Agjencioni në faqen 2 të vendimit të saj ka bërë të qartë që Agjencia nuk e ka trajtuar Ligjshmërinë e Planit Zhvillimor Komunal, rregulluesin e procesit të hartimit dhe miratimit të këtij Plani, pasi që çështjet e tilla nuk janë në kompetencë të Agjencisë sipas Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe LPKI-së. Pra, PZHK dhe Vendimi që është marrë nga Kuvendi i kaluar ka qenë në rregull në aspektet ligjore, ajo çka ka drejtuar Agjencioni për Parandalimin e Korrupsionit është se pas ankesës së Grupit Parlamentar të PSD-së, për Konflikt të Interesit ndaj ish-asambleistit të tyre Fitim Gagica, Agjencioni ka konstatuar se i njëjti ka bërë Kërkesë në periudhën e Dëgjimeve Publike gjatë hartimit të PZHK-së, për ndryshim të dëstinineve të pronave të tije nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Prandaj, këtu them se nuk pajtohem plotësisht thu se toka bujqësore nuk qenka profitabile e toka ndërtimore qenka profitabile. Një ish- asambleistë apo një asambleistë aktual i cili voton Buxhetin e Komunës e në të ardhmen përfiton familja, motra, vëllau apo fmija i vet një bursë, një mbështetje komunale, një rrugë apo një ndriçim nuk qenka konflikt interesi, prandaj rekoamdnimin që ka vendos Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk qenka më i miri i mundshëm, sidoqoftë ne si Komunë jemi në rregull me gjitha vendimet që i kemi marrë me Planin Zhvillimor Komunal, për të parandaluar edhe veprën penale ndaj ish-asambleistit Fitim Gagica ne po e hedhim në votim Konfliktin e Interesit, dhe jo Planin Zhvillimor Komunal që tashmë është miratuar, edhe Kryesuesja e bëri të qartë që Asamblesitët që kanë bërë Kërkesë gjatë dëgjimeve buxhetore për ridestitim të parcelave të tyre apo familjarët e tyre , mundësisht të mos jenë pjesë e vendimmarrjes të këtij akti, përndryshe në nuk do ta sjellim më në rivotim të dytë nëse konstatohet që edhe pas lajmërimit

tonë dikush merë pjesë në votim dhe përgjegjësia mbetet individuale, nuk është institucionale dhe kërkojmë që ky akt të gjejë mbështetjen e juaj. Faleminderit shumë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime rreth kësaj pike ? Fjala për Labinot Skovrqanin

Labinot Skovrqani, Unë veq e shoh këtë punë që është e keqe me na qit neve në këso pozicioni, ku p.sh gjithë secili mundet me pas familjar që kanë bërë kërkesa për ndryshim destinacioni të pronave pa mare parasysh, një njeri që që jeton në Kamenicës edhe është Asambleistë mos me pas të drejtë me punu apo me zhvillu pronën e vet mendoj që kjo është absurde që e kanë mare këtë vendim, dhe unë po e liroj sallën. Nuk do mare pjesë në votim e diskutim se ka familjar që kanë bërë kërkesa.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Burbuqe Leka

Burbuqe Leka, Përshëndetje për të gjithë, edhe unë sikurse Labinoti, deshta me nda me ju këtë shqetësim, ne mujm me u përgjigj vetëm për vetën tonë dhe jo edhe për familjar, çka kanë bërë Kërkesa për ridestitim familjart e tonë ne mundemi edhe mos me ditë, unë ndoshta kam pak njohuri kush se çka mund nie kërku, mirëpo ne nuk mundemi mu përzi të bëjnë apo mos të bëjnë kërkesa, secili bënë kërkesa për pronat e veta, ne mundmi me dhanë përgjigje për kërkesa tona dhe jo për familjar se jo që nuk dojmë por mund edhe mos ta dijme. Faleminderit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diçka tjetër për diskutime shtesë, atëherë e hedhim në votim

Kush është për miratim

Për 10

Kundër 0

Abstenim 1, konstatojmë se është miratuar kjo pikë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i Informatës nga Raporti i Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025,

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Shqyrtimi i Informatës nga Raporti i Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, fjalën e ka Kryetarit i Komunës për ta prezantuar .

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, E para Administrata e Kuvendit, asambleistët e kuvendit që dolën qysh nga pika e 2-3 e rendit të ditës, o të vijnë këtu në mbledhje o le të deklarohen që e kanë lëshuar mbledhjen, janë të zgjedhur të qytetarëve dhe kanë përgjegjësi me mare pjesë në kuvend, dhe ju kisha lutur që për mbledhjet e ardhshme të Kuvendit Komunal që Lista për Nënshkrime të ua dërgoni asambleistëve në fund të mbledhjes, ose i bëni dy lista një në fillim e një në fund, e jo të nënshkruhen e pas 2-3 pikave të dalin nga mbledhja, duhet të jenë këtu për të diskutuar dhe mbrojtur interesat e qytetarëve. Informata për raportin e njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, janë konfidenciale dhe i dorëzohen vetëm zyrës së kryetarit, po i ndajmë ato që janë më të rëndësishmet dhe konsiderojmë që janë të lejshme edhe për qytetarët edhe për këshilltarët komunal. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2025 në procesin e auditimit ka mbuluar disa fusha. Në vitin 2025 në procesin e Auditimit janë mbuluar këto fusha:

Menaxhimi i pasurisë në të gjitha njësitë buxhetore të komunës për vitin 2024.

- Prokurimi për vitin 2024.

- Të hyrat në Drejtorinë për Arsim për vitet 2022, 2023 dhe 2024.

- Menaxhimi i kontratave publike për vitin 2024.

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në njësinë buxhetore të arsimit për prej datës 01.08.2023 deri më 31.07.2025.

- Të hyrat nga tatimi në pronë për periudhën prej 01.11.2024 deri më 20.10.2025.

Një përmbledhje e rimëkëmbjeve dhe kursimeve si rezultat i aktivitetit auditues.

Sa i përket rimëkëmbjeve dhe kursimeve gjatë aktivitetëve të auditimit të Njesisë së

Auditimit të Brendshëm, kjo njësi mendon që i ka arritur në të gjitha auditimet sepse gjatë

auditimeve të bëra ka dhënë rekomandime që proceset e audituara të përmirësohen

Në auditimet për vitin 2025 janë dhënë gjithsej nëntë (9) rekomandime. Gjatë përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve, në mostrat e testuara kemi gjetur që:

- 3 rekomandime janë zbatuar në tërësi,

- 6 rekomandime nuk janë zbatuar.

Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2025 ka verifikuar edhe rekomandimet që kanë qenë në proces nga auditimet e vitit 2024, të përmbushen. Njësia e Auditimit të Brendshëm do të angazhohet edhe më tepër në ekonomizimin, efikasitetin dhe efektivitetin e burimeve të përdorura për të gjitha sistemet dhe proceset e komunës. Ky angazhim do të rezultojë me:

- kryerjen e auditimeve sipas planeve të miratuara.

- raportim dhe përcjellje në vazhdimësi e zbatimit të rekomandimeve

- rishikimin dhe rivlerësimin planit strategjik të auditimit.

- interpretim dhe përmbajtje ndaj standardeve profesionale dhe udhëzimeve tjera.

- paraqitje të integritetit dhe përgjegjësisë profesionale me qëllim që të përditësoj ndryshimet në legjislacion dhe zhvillimet brenda profesionit të auditimit.

- zhvillim të mëtutjeshëm të marrëdhënëve produktive të punës ndërmjet auditorit të brendshëm, menaxhmentit të njësive shpenzuese, njësive buxhetore, menaxhmentit të lartë dhe auditorëve të jashtëm.

- jetësim të proceseve efektive të shqyrtimit në të gjitha fazat e ciklit të auditimit.

- rritjen e numrit të auditorëve të brendshëm të njësisë sipas legjislacionit administrative, ky dokument informativ është përcjellë tek të gjithë asambleistët, nëse konsideroni se keni diçka për të diskutuar jemi këtu. Faleminderit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, A kemi diskutime për këtë pikë, nëse jo. Atëherë vazhdojmë me pikën e tetë.

8. Shqyrtimi i Informatës së Këshillit Komunal për Siguri dhe Bashkësi (KKSB) për vitin 2025, -

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika tetë, Shqyrtimi i Informatës së Këshillit Komunal për Siguri dhe Bashkësi (KKSB) për vitin 2025, fjala është për Kryetarin.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit shumë, siqë e dini është një Komunitet për Siguri dhe Bashkësi që themelohet nga Kuvendi Komunal, e që në

mbledhjen e radhës po besojë që do vijmë me një propozim vendim për themelimin e këtij komuniteti që ka rol të rëndësishëm, përgjatë vitit jemi të obliguar të mbajm 6-të mbledhje, dhe përfshihen institucione të ndryshme komunale, ato të sigurisë

Kuvendi Komunal i Kamenicës ka themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi i cili Vendim mban numrin Sh.01.Nr.6165 dt.04/03/2022 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Sh.01. Nr.23689 dt.18/07/2023k ka mabjtur (2) dy mbledhje të rregullta.

Mbledhja e parë

1. Trajtimi i sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, me theks të veçantë në dhunën emocionale dhe psikologjike;
2. Informatë lidhur me planin e punës së KKSB-së;
3. Të ndryshme.

Mbledhja e dytë

1. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitutional, përkatësisht bashkëpunimi ndërmjet Policisë, institucioneve arsimore dhe shërbimeve sociale;
2. Ndikimi i mos përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga Memorandumi i Bashkëpunimit për “Rikonstruimin dhe asfaltimin e rrugës Shipashnicë e Ulët – Bujnoc – Guri i Bardhë – Kikë”, nr. **Sh.02 Nr.18513**, datë **18.04.2017**, i nënshkruar ndërmjet kompanisë **Air-Energy** dhe Komunës së Kamenicës;
3. Mosdorëzimi i një plani preventiv për mbrojtje nga ngricat nga kompania “**Girish**”;
4. Të ndryshme.

Anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi gjatë vitit 2025 kanë përcjellë në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet e përditshme shoqërore, me qëllim të identifikimit dhe adresimit të problematikave të qytetarëve nga fusha e sigurisë, duke u kujdesur për çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën dhe mirëqenien e tyre.

Me të gjitha procesverbalet e mbledhjeve është njoftuar Ministria e Punëve të Brendshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Me këtë rast dua të falënderoj edhe koordinatoren e KKSB-së, Fisnik Kastrati-n, Faleminderit shumë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, A kemi diskutime për këtë pikë, nëse jo. Atëherë vazhdojmë me pikën e nëntë.

9. Shqyrtimi Raportit të Performancës Komunale për vitin 2024.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale, Fjala për Lidiona Marovcen për ta prezantuar këtë raport në cilësinë e Koordinatorës .

Lidiona Marovca: Përsëndetje për të gjithë,
I nderuar Kryetar i Komunës z.Kadri Rahimaj,
E nderuara Kryesuese znj. Arbnore Beqiraj Fera,
Të nderuar asambleistë,

Duke ditur se paraqitjet e mia para kuvendit apo komiteteve të tilla janë të rralla, shfrytëzoj rastin të ju uroj për mandatin e ri, duke ju uruar një mandat të mbarë dhe një vit të mbarë, sidomos duke uruar që në secilën ngritje dore që bëni në këtë kuvend të jetë në interes të qytetarit dhe gjithmonë pjesë e bazës të jetë vet ai.

Më lejoni që të bëjë një prezantim të shkurtër rreth pjesës së performancës për vitin 2024 për Komunën e Kamenicës.

Raportimi për vitin 2024 nga Komuna e Kamenicës, ka përfunduar tre ditë para kohës së paracaktuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për dallim nga komunat e tjera që kanë kërkuar kohë shtesë, kohë kjo e fituar nga ne për të përmirësuar dhe ndryshuar raportimin e bërë deri në atë kohë.

Në kuadër të raportimit, Komuna e Kamenicës ka marrë gjithsej 32 pikë nga 98 pikë të mundshme, për 29 tregues gjithsej.

Kjo gjë nuk e kualifikon Komunën e Kamenicës për të qenë përfituese e grantit.

Komuna e Kamenicës, ka plotësuar vetëm tri nga 4 kushtet minimale për të qenë përfituese, që janë:

1. Komuna ka raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të paracaktuar në nenin 19.2 të ligjit për SMPK/GPK,
2. Komuna ka respektuar obligimin ligjor për të rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës,
3. Si dhe opinioni i auditimit është i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Kurse kushti i vetëm që Komuna e Kamenicë nuk ka arritur që ta plotësojë, është shpenzimi i 75% apo më shumë i buxhetit për investime kapitale, sepse Komuna e Kamenicës për vitin 2024 ka shpenzuar vetëm 66% e buxhetit për investime kapitale.

Kjo ndodhë për arsye të ndryshme, duke filluar nga procedurat në prokurim, vonesat në realizim të punëve e puna e zhvilluar nga operatori ekonomik.

Në të njëjtën kohë, këtë vit kemi pranuar thirrjen e Ministrisë për raportim, dhe kemi bërë gati vendimin për grupin punues.

Raportimi do të fillojë me datën 15 shkurt nëse nuk do të ketë probleme teknike me sistemin apo vonesa të tjera që mund ta shtyejnë pjesën e fillimit të raportimit.

Nëse dikush ka ndonjë pyetje, urdhëroni.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Labinot Skovrqani

Labinot Skovërqani: Ne kemi paravetës raportin e Performancës që veq se e kemi lexuar Pse penalizohemi me pikë tek treguesi për pjesëmarrjen e Kryetarit nëpër seanca, a nuk është arsyetuar nga Komuna ?

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës: Po sepse për shkak të agjendës unë ka munguar në dy seanca, dhe është indikator që unë duhet të jem present.

Labinot Skovërqani: Po por ne po penalizohemi me pikë për shkak të kësaj.

Lidiona Marovca: Ministria sheh pjesëmarrjen dhe jo arsyen, ajo nuk merr në konsideratë arsyen e mungesës së Kryetarit për këtë vlerësim.

Dikush tjetër?

Ju falemnderit shumë!

10. Propozim Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2026.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, kalojm te pika e dhjetë, ka të bëjë me Propozim –vendim për themelimin e grupit punues për Hartimin e Planit vjetor të Punës së Kuvendit Komunal të Komunës së Kamenicës për vitin 2026. Ky Grup punues do të përbëhet nga 9 anëtar unë Arbnore Beqiraj Fera si Kryesuese e Kuvendit dhe njëherit edhe kryesuese e këtij grupi punues, nga Shërbimi i Kuvendit znj. Violeta Krasniqi, nga gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend nga një anëtarë si dhe një përfaqësues nga Shoqëria Civile. Fillojmë me propozimet nga subjekti politikë
LVV-PSD-AAK-LDK-PDK-LS

LVV propozon Liridon Kastrati
PSD propozon Djellonë Rrudhani Ahmeti
AAK propozon Labinot Skovrqani
LDK propozon Jeton Biqkaj
PDK propozohet Granit Berisha
LS propozohet Ivan Markovic

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Grupi Punues do të përbëhet nga këta anëtar, lexojmë emrat e komisionit të propozuar

LVV propozon Liridon Kastrati
PSD propozon Djellonë Rrudhani Ahmeti
AAK propozon Labinot Skovrqani
LDK propozon Jeton Biqkaj
PDK propozohet Granit Berisha
LS propozohet Ivan Markovic
Unë Arbnore Beqiraj Fera
Violeta Krasniqi- Zyrtare për punë të Kuvendit Komunal, si dhe
Një përfaqësues nga Shoqëria Civile

Kush është për miratimin e këtij grupi ?

Për 15

Kunder 0

Abstenim 0

11. Kërkesë nga MAPL për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. Sh.01 Nr. 36248.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e njëmbëdhjetë e cila ka të bëjë me Vendimin me nr. 36248 për publikim të Listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026, MAPL ka

kthyer në rishqyrtim duke arsyetuar se Listat e Pronave nuk e kanë përmbushur dhe nuk janë në pajtim me nenin 13 të Ligjit 06/L-092, ku Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ka rishikuar Listat, i ka plotësuar dhe harmonizuar me kërkesat dhe rekomandimet e MAPL-së. Andaj e hedhim në votim Listat e harmonizuara

Kush është për miratimin e këtyre listave të harmonizuara ?

Për 15

Kundër 0

Abstenim 0

12. Kërkesë nga MAPL për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. Sh.01 Nr. 21283.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika 12-të, ka të bëjë me vendimin me nr. 21283 MAPL ka kthyer këtë vendim me Rekomandime për rishqyrtim, andaj ky vendim për tu harmonizuar duhet të Shfuqizohet pjesërisht, konkretisht pjesa që i referohet Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të komunës. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës, përcaktohet një sipërfaqe prej 9 m² për vendosjen e trafos elektrike, vetëm si perceptim teknik dhe lokacional, pa krijuar të drejtë shfrytëzimi, posedimi apo ndonjë të drejtë reale mbi pronën komunale.

Kush është për miratimin e këtij Propozim vendimi për Rishqyrtimin e Vendimit me nr Sh.01 Nr. 21283 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike

Kush është ?

Për 15

Kundër 0

Abstenim 0, miratohet.


13. Të ndryshme

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime në kuadër të pikës të ndryshme, nëse jo atëherë unë kisha kërkuar nga të gjithë Asambleistët të dërgojnë nga një Biografi dhe nga një foto te Valdete Berisha-zyrtare për informim.

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, konstatojmë të mbyllur mbledhjen sotme.


Takimi mbyllet në orën 11:30

Procesmbajtëse


Violeta Krasniqi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës


Arbnore BEQIRAJ FERA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PLANI I PUNËS
SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN 2026

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Ai ushtron funksionet e tij në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës, Rregullores së Punës dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në kuadër të kompetencave të tij, Kuvendi i Komunës merr vendime me rëndësi të veçantë për funksionimin institucional të Komunës, duke përfshirë miratimin e Statutit dhe Rregullores së Punës, miratimin e buxhetit dhe planeve investuese, çështjet financiare të rezervuara për Kuvendin, planin vjetor të punës dhe raportin vjetor, nivelin e tarifave dhe ngarkesave, si dhe vendime të tjera të përcaktuara me ligj.

Kuvendi i Komunës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka gjithashtu përgjegjësi në krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, emërimin dhe rrimërimin e rrugëve dhe vendeve publike, arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale, si dhe marrjen e vendimeve për anëtarësim në asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës.

Komuna siguron kushte të përshtatshme për mbajtjen e seancave të Kuvendit të Komunës, mundëson pjesëmarrjen e qytetarëve në seanca dhe garanton transparencë të plotë për të gjitha vendimet dhe aktet.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi mund t'ia delegojë pushtetin komitetit të caktuar të Kuvendit ose Kryetarit të Komunës, me të drejtë që delegimi të tërhiqet në çdo kohë.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës është hartuar në përputhje me **Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit** dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Plani strukturohet sipas një kornize logjike dhe planifikon realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të Kuvendit, duke synuar funksionim të qartë, të koordinuar dhe transparent.

Për vitin 2026 Kuvendi planifikon të mbajë të paktën **12 seanca të rregullta**, ku do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të komunës dhe qytetarëve. Në kuadër të këtyre seancave, Plani parashikon:

- Organizimin e mbledhjeve sipas Rregullores së Punës dhe akteve në fuqi;
- Funksionalizimin e plotë të komiteteve, komisioneve dhe trupave tjerë të Kuvendit, si dhe raportimin e tyre para Kuvendit të paktën një herë në vit;
- Shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës;
- Miratimin e buxhetit, planeve investuese, planit vjetor të prokurimit, planit të punës së auditorit të brendshëm dhe planeve rregulluese;
- Miratimin e çështjeve financiare të rezervuara për Kuvendin;
- Shqyrtimin dhe harmonizimin e rregulloreve ekzistuese dhe miratimin e rregulloreve të reja;
- Mbikëqyrjen, analizimin dhe vlerësimin e punës së Ekzekutivit të Komunës.

Ky plan synon të sigurojë një funksionim efektiv dhe të koordinuar të Kuvendit, si dhe pjesëmarrje aktive dhe transparencë të plotë ndaj qytetarëve të Kamenicës.

Përfundim :

Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës do të ndihmojë dhe lehtësojë zhvillimin e punimeve të mbledhjeve të Kuvendit. Duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë të qartë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2026, të cilat lidhen me interesat e Komunës dhe të qytetarëve në përgjithësi.

Me këtë plan pune janë paraparë 12 (dymbëdhjetë) mbledhje të rregullta, ndërsa sipas nevojës mund të mbahen edhe mbledhje të tjera, përfshirë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne, ashtu siç parashihet me Ligj, Statutin e Komunës dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore, varësisht nga fushat dhe kompetencat përkatëse.

Kryesuesja e Kuvendit, varësisht nevojave, mban takime mujore me përfaqësuesit/shefat e grupeve të këshilltarëve nga subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend, me qëllim të bashkërendimit të punës së komiteteve obligative dhe funksionale, si dhe të punës së Kuvendit të Komunës.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të aktiviteteve sipas dinamikës së përcaktuar me këtë plan, do të përkujdeset Kryesuesja e Kuvendit.

Realizimi i Planit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, i cili duhet që sa më shumë të jetë e mundur, t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2026.

Plani i punës së Kuvendit, sipas dinamikës mujore, përfshin: emërtimin e aktit/dokumentit, objektivin e tij.

Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2026, sipas nevojave, mund të plotësohet dhe ndryshohet.

Në vijim në mënyrë tabelore për çdo muaj paraqesim aktivitetet e mbledhjeve të Kuvendit.

Rendi i Ditës

JANAR 2026

• Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2025.
• Shqyrtimi i Raportit të Kuvendit Komunal të Kamenicës për vitin 2025.
• Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor (TM4) 2025.
• Shqyrtimi Raportit të Performancës Komunale për vitin 2024.
• Shqyrtimi i Informatës së Raportit të Njësisë së Auditimit të Brenshëm për vitin 2025
• Shqyrtimi i Informatës së Këshillit Komunal për Siguri dhe Bashkësi (KKSB) për vitin 2025
• Propozim Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2026.
• Kërkesë nga MAPL për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. Sh.01 Nr. 36248.
• Kërkesë nga MAPL për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr. Sh.01 Nr. 21283.
• Propozim vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033.
• Të ndryshme

Shkurt 2026

• Shqyrtimi dhe Aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026
• Propozim Vendim për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
• Të ndryshme

Mars 2026

• Informatë mbi Kriteret dhe Indikatorët e Përformancës
• Bartja e Mjeteve Financiare të Pashpenzuara nga viti 2024-2025 në vitin 2026
• Plani i Punës së Prokurimit për vitin 2026
• Raporti Vjetor Financiar Janar-Dhjetor 2025
• Të ndryshme

Prill 2026

• Raporti Financiar për Periudhën Janar – Mars 2026.
• Raporti Periodik Lidhur me Progresin e Zatimit të Rekomandimeve të Auditorit .
• Hartimi i Rregulloreve të Ndryshme Komunale.
• Të ndryshme.

Maj 2026

• Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2026.
• Informatë mbi Qarkoren e parë Buxhetore të MF-së
• Të ndryshme.

Qershor 2026

• Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
• Raporti i Prokurimit për vitin 2026
• Informatë mbi Zbatimin e Planit të Prokurimit për vitin 2026
• Të ndryshme

Korrik 2026

• Raporti i dytë Financiar për Periudhën Prill – Qershor 2026.
• Raporti i gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës së Kamenicës.
• Informatë për Aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për Gjashtë Mujorin e Parë të Vitit 2026.
• Raporti për Vlerësimin e Performancës së Komunës për vitin 2025.
• Të ndryshme

Gusht 2026

• Informatë mbi Suksesin e Arritur të Nxënësve në fund të Gjysëmvjetorit të Dytë të Vitit Shkollor 2026-2027.
• Informatë mbi Qarkoren e dytë të brendshme Komunale
• Shqyrtimi i rregulloreve të ndryshme Komunale
• Informatë për Korrje-Shirjet për vitin 2026,
• Të ndryshme

Shtator 2026

- | |
|---|
| • Miratimi buxhetit të Komunës për vitin 2026 dhe Parashikimet Buxhetore për vitin 2027-2028. |
| • Informatë mbi Përfundimin e vitit të ri Shkollor 2025/2026. |
| • Të ndryshme |

Tetor 2026

- | |
|---|
| • Raporti Financiar për Periudhën Korrik – Shtator 2026. |
| • Raporti Periodik lidhur me Progresin e Zbatimit të Rekomandimeve të Auditorit . |
| • Hartimi, Miratimi i Rregulloreve të reja Komunale |
| • Të ndryshme |

Nëntor 2026

- | |
|--|
| • Informatë mbi Mbjelljet Vjeshtore nga Drejtoria e Bujqësisë. |
| • Informatë mbi Gjendjen në Shëndetësi. |
| • Të ndryshme |

Dhjetor 2026


- | |
|--|
| • Raporti mbi Planin e Prokurimit të Komunës për vitin 2026. |
| • Informatë për Aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026. |
| • Informatë për Zbatimin e Planit vjetor të Prokurimit |
| • Informatë mbi Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm . |
| • Propozim Vendim për Themelimin e Grupit Punues për Hartimin e Draft-Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2027 |
| • Të ndryshme |


Arbnore BEQIRAJ EERA

Kryesuese e Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Bazuar në nenin 13 dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2026, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës

1. Ndryshohet paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, dhe riformulohet si vijon:
2. Paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të anëtarit të Komisionit **z. Selami Klaiqi (DKA)**, caktohet anëtare e Komisionit **znj. Belgizare Kryeziu** (Drejtoreshë e Shkollës "Metush Krasniqi", Rogaçicë).
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
4. Bashkëngjitur këtij Vendimi është Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës – MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të internetit të Komunës.

Arsyetim

Me Vendimin Sh.01 Nr.21967, datë 12.08.2025, është formuar Komisioni për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, në përbërje të të cilit është emëruar edhe z. Selami Klaiqi, i cili në atë kohë ushtronte detyrën e Drejtorit të Gjimnazit “Ismail Qemali” në Kamenicë.

Ndërkohë, z. Selami Klaiqi është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit. Duke marrë parasysh se Rregullorja (QRK) Nr. 19/2024 përcakton përbërjen e Komisionit dhe nuk parasheh që Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit të jetë pjesë e këtij komisioni, është e nevojshme që ai të lirohet nga detyra e anëtarit të Komisionit dhe të zëvendësohet në përputhje me dispozitat në fuqi.

Për këtë arsye propozohet ndryshimi i nënparagrafit 2.2 të Vendimit Bazë dhe zëvendësimi i tij me anëtarin e re të Komisionit, me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt dhe të pandërprerë të Komisionit.

Vendimi i u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Drejtorisë Komunale të Arsimit; dhe
- QSHQ - Arkivit;





Republika e Kosovës
Republika Kosovë
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA OF KOSOVO
CENTRALE SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. 01
Br. 21967
Nr. i faq. 01
Data: 12/08
Datum: 2025
KAMENICEJA

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më:06.08.2025

Bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 2 shkronja d), nenin 17 shkronja h) dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenin 38, paragrafi 38.1 të Statutit 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, me kërkesën Sh.05.Nr.18786, të datës 22.07.2025, të parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.07.2025, miratoi këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës

1. Formohet Komisioni për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1. Ramadan Guda – (Zyrtar në DKA);
 - 2.2. Selami Klaiqi – (Drejtore në Gjimnazin "Ismail Qemali", Kamenicë); dhe
 - 2.3. _____ – (MASHTI).
3. Komisioni përzgjedhës obligohet që punët t'i kryejë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Mandati i Komisionit zgjat deri në nxjerrjen e vendimit/vendimeve përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatit/kandidatëve në pozitën/pozitat e shpallura me konkurs.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të kuvendit dhe pas publikimit në uebfaqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë Komunale të Arsimit, Zyrës së përkthimeve, MAPL-së, QSHQ- Arkivit.

